



KUVENDI I KOMUNËS KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA

EKSTRAKT

nga procesverbali i mbajtur më 26 shkurt 2015, në mbledhjen e XIV-të
(katërmëdhjetë) të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Mbledhja u mbajt në sallën nr. 31 dhe filloi në orën 14.00’.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z. Mehmet Gashi, kryesues i Kuvendit, përkatësisht kryesues i këtij Komiteti.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e këtij Komiteti, përkatësisht Afrim Shabani, Bahri Blakçori, z. Islam Revuçi Fidan Rekaliu , Haki Rudari, , Kadri Avdiu, Kumrie Hoti, Mynavere Abdullahau – Krasniqi, Naim Çunaku dhe Rafet Llapashtica.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë dhe vendimarrje.

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe z. Isuf Latifi, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave dhe z. Durim Salihu, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit.

Kryesuesi z. Mehmet Gashi, fillimisht kërkoi falje për shtyrjen e mbledhjes për një orë, shtyrje e cila është bërë me arsye në pajtim me shfatat e Grupeve të këshilltarëve të subjekteve politike.

1. Miratimi i rendit të ditës

z. Haki Rudari, theksoi, në mbledhjen e fundit kam kërkuar një raport nga Komisioni vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale përkatësisht të objekteve ish Hotel “ Llapi “ dhe ish SHKSH, këtë të fundit deri vonë e ka shfrytëzuar Banka Private e Biznesit, mirëpo kjo çështje nuk është marr në konsideratë, andaj propozoj që të përfshihet në rend të ditës të mbledhjes së sotme.

Kryesuesi z. Mehmet Gashi, theksoi, duke u bazuar se çështja të cilën e propozoi parafolësi nuk mund të shqyrtohet pa përgatitjen parapake të materialit nga ana e Ekzekutivit, unë jam i mendimit se mund të miratojmë vetëm një rekomandim që për mbledhjen e ardhshme të përgatitet raporti përkatës.

Rendi i propozuar i ditës u miratua me shumicë votash, përkatësisht 9 vota për dhe në votë kundër, së bashku me propozimin e kryesuesit.

2. Propozimi i vendimit për bartjen e të hyrave vetanake të Komunës së Podujevës nga viti 2014 në vitin 2015 dhe destinimin në kategori të caktuara buxhetore

z. Isuf Latifi, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, e paraqiti fjalën hyrëse.

z. Haki Rudari, theksoi, në realitet për mua është e pa arsyeshme të teprohen mjete buxhetore nga kategoria e të hyrave vetanake kur kemi vend për investime të shumta. Konsideroj se në komunat ku bëhet ndërrimi i subjekteve politike të cilat e udhëheqin Ekzekutivin është më vështirë të menaxhohet buxheti ngase ndryshojnë projektet, mirëpo në rastet si komuna e jonë e cila prej pas lufte qeveriset nga e njëjta parti, mendoj se është një shenjë jo e mirë që teprojnë mjete nga të hyrat vetanake, përkatësisht që mjetet e arkëtuara nuk shpenzohen.

Gjithashtu vërejtja ime konsiston edhe te bartja e mjeteve në programet përkatëse, në Administratën komunale barten 153.681,46 € ngase sipas mendimit tim është shumë e madhe derisa në sektorin e bujqësisë nuk barten fare mjete kur dihet se në komunën tonë pjesa më e madhe e qytetarëve merren me bujqësi.

Te sektori i shëndetësisë, Grupi i këshilltarëve i LVV – së, në vijimësi ka kërkuar që lehonat të ndihmohen me një shumë të caktuar financiare, mirëpo kjo çështje nuk është marr në konsideratë me arsyetim se nuk ka mjete buxhetore, ndërsa tash kur shihet se ka mjete do duhej që një shumë e caktuar të alokohet për kategorinë e cekur.

Për sektorin e arsimit janë paraparë 110.000,00 € dhe atë për zgjerimin e objekteve shkollore, mirëpo nuk specifikohet se objektet e cilave shkolla do të zgjerohen. Sa i përket objekteve shkollore jam i mendimit se investime duhet bërë edhe në aspektin e sigurisë, ndërtimit të trotuareve, pastërtia dhe gjelbërimi.

z. Fidan Rekalii, theksoi, ne Grupi i këshilltarëve i LDK – së e mbështesim propozimin e këtij vendimi ngase jemi të mendimit se kategoritë në të cilat është propozuar të barten mjetet përkatëse kanë nevojë për buxhet shtesë, andaj duhet të shfrytëzohet kjo mundësi e mbi të gjitha për faktin se këto bartje të mjeteve bëhen plotësisht në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi.

z. Rafet Llapashtica, theksoi, mua më ka bërë përshtypje fakti se së paku dy vitet e fundit, mjetet përkatëse vetanake, përcillen në vitin vijues me destinim pothuajse të njëjtë siç është rasti zgjerimi dhe renovimi i objekteve shkollore që ka qenë edhe vitin e kaluar dhe atë në mënyrë të paspecifikuar, pra nuk e kemi ditur se në cilat shkolla do të investohen mjetet e destinuara. Jemi në dijeni se ne i kemi përmendur dy objekte shkollore dhe atë në fshatrat Batllavë dhe Halabak që janë në gjendje shumë të keqe për të cilat ka nevojë që të ndërhyhet në mënyrë urgjente, përkatësisht të ndërtohen objektet e reja.

Kërkesa ime është që në mbledhjen e nesërme të Kuvendit të jenë të pranishëm edhe drejtorët e Drejtorive në të cilat bëhet transferi i mjeteve ngase mund të ketë pyetje të cilat do t'ju parashtrihen atyre, në mënyrë që mjetet të destinohen aty ku nevoja është më e madhe.

z. Kadri Avdiu, theksoi, jemi në dijeni se për çdo vit mjetet e pashpenzuara nga kategoria e të hyrave vetanake barten në vitin vijues dhe nëse këto mjete nuk

barten në afatin e paraparë ligjor të njëjtat mund të humbin, andaj ne duhet ta përmbushim këtë obligim. Pajtohem me parafolësin se duhet të ndërmarrim të gjitha aktivitetet dhe të bashkëpunojmë edhe me MASHT-in që të fillohet me ndërtimin e objekteve shkollore të cilat nuk i plotësojnë kushtet e në veçanti objekti i shkollës në fshatin Halabak i cili as afërsisht nuk i plotëson kushtet elementare për zhvillimin e procesit mësimor, për të cilin edhe Komuna do duhej të gjejë mundësitë buxhetore për të bashkëfinancuar objektin e cekur.

z. Haki Rudari, theksoi, sa i përket investimeve në arsim, në propozimin e vendimit thuhet, zgjerimi dhe renovimi i objekteve shkollore, kjo dallon nga ndërtimi i objekteve, andaj në këto rrethana duhet të kemi kujdes. Mirë është që këto mjete nuk humbin por edhe më mirë do të ishte që të njëjtat të investoheshin në vitin 2014 në projekte të ndryshme.

z. Mynavere Abdullahu Krasniqi, theksoi, drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, në fjalën hyrëse, shumë mirë e sqaroi të hyrat vetanake kanë qenë të planifikuara në kategoritë përkatëse, mirëpo mjetet e arkëtuara në fund të vitit nuk kanë mundur të shpenzohen, andaj konsideroj se për këtë çështje nuk kemi çfarë të diskutojmë por vetëm ta mbështesim propozimin e këtij vendimi.

z. Rafet Llapashtica, theksoi, nuk pajtohem me parafolësen ngase mbi 100.000 € janë tërhequr nga Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit dhe atë nga projektet prioritare të miratuara në Kuvend, prioritete të cilat ende janë në fuqi duke u bazuar nuk janë shfuqizuar nga Kuvendi, andaj vetëm kur Kuvendi i heq nga prioritetet projektet përkatëse, atëherë mjetet e caktuara mund të barten në projekte të tjera konkrete. Mënyrën e kështillë e konsideroj joprofesionale ngase si të thuhet ndryshe kur drejtori i Drejtorisë së Arsimit kërkon mjete shtesë 110.000 € ndërsa nuk paraqet asnjë projekt se ku do të investohen ato mjete.

z. Isuf Latifi, theksoi, zakonisht po jap përgjigje të njëjta ngase edhe pyetjet po bëhen të njëjta, fillimisht theksova se me Ligjin e Buxhetit për vitin 2015 të hyrat vetanake të pashpenzuara në mënyrë automatike me vendim të Kuvendit të Komunës barten në vitin vijues, këto të hyra vetanake nuk mund të barten në projekte të reja por mund të barten vetëm në projektet që kanë qenë në prioritet në vitin 2014. z. Rafet Llapashtica, tha se janë marr mjetet nga Drejtoria e Planifikimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit e janë bartë në sektorin e arsimit, kjo nuk qëndron meqë për Drejtorinë e Arsimit nga të hyrat vetanake kanë qenë të planifikuara 250.000 €, mirëpo nuk kemi arritur ta arkëtojmë shumën e planifikuar të të hyrave të gjithmbarshme prej 1 milion e 400 mijë €, kemi mbetur mungesë për afro 200.000 €, për këtë arsye shuma prej 110.000 € është propozuar të bartet në të njëjtin projekt përkatësisht zgjerimi dhe renovimi i objekteve shkollore.

U përmend përse nuk është propozuar bartja e mjeteve në sektorin e bujqësisë, lidhur me këtë mund të them se të gjitha projektet e planifikuara në vitin 2014 në sektorin e bujqësisë janë realizuar 100%.

z. Haki Rudari, theksoi, ne Grupi i këshilltarëve i LVV-së, në muajin shtator 2014, kemi propozuar të gjenden mundësitë buxhetore për sigurimin e ndihmës në ushqim për nxënës nga klasa e I – re deri në klasë të V – të, e për realizimin e këtij projekti Komunës së Podujevës, për një vit do t'i kushtonte 30,000,00 €, mirëpo kërkesat e opozitës nuk po merren në konsideratë.

Kryesuesi z. Mehmet Gashi, theksoi, mjetet e arkëtuara të të hyrave vetanake në muajt nëntor dhe dhjetor, asnjë komunë në Kosovë nuk mund t'i shfrytëzojnë pa kaluar përmes Ministrisë përkatëse përkatësisht thesarit dhe mund të shfrytëzohen në fillim të vitit vijues në bazë të vendimit të Kuvendit.

Mjetet e parapara në Administratë janë për projekte prioritare të vitit të kaluar mbi bazën e kontratave konkrete.

z. Afrim Shabani, theksoi, e mbështes kërkesën e z. Haki Rudarit për ofrimin e një shujtë modeste nxënësve prej klasës së I –rë deri në klasën e V – të, mirëpo më herët drejtori z. Isuf Latifi sqaroi se tjetër janë dëshirat e tjetër mundësitë buxhetore dhe shtoi, në jemi në dijeni se në shtete perëndimore shkollat i kanë edhe kuzhinat, e këtë tash për tash nuk kemi mundësi ta bëjmë por shpresojmë se në një të ardhme të afërt edhe ne do të krijojmë kushtet e cekura perëndimore.

Pas votimit u konstatua se propozimi i këtij vendimi, Kuvendit i rekomandohet për shqyrtim me shumicë votash përkatësisht 9 vota për, 1 votë kundër dhe asnjë votë të përmbajtur.

3. Propozimi i vendimit për transfer të mjeteve buxhetore në kategorinë e pagave në sektorin e arsimit për vitin 2015

z. Isuf Latifi, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, e paraqiti fjalën hyrëse.

z. Kryesuesi z. Mehmet Gashi, theksoi, nga Ministria e Financave, ditë më parë, e kam pranuar një shkresë me të dhënat për të gjitha organizatat buxhetore përmes të cilës jam informuar se për çështjen për të cilën jemi duke debatuar thuajse të gjitha komunat e Republikës së Kosovës kishin mungesë buxheti, mirëpo krahasuar me komunat tjera në komunën tonë mungesa buxhetore është e vogël dhe nëse kjo nuk plotësohet mësimdhënësit do të mbesin pa paga mujore.

z. Kadri Avdiu, theksoi, jemi në dijeni se çështja për të cilën po diskutojmë është problematike në gjithë Republikën e Kosovës, shpresoj se ky problem gjatë këtij viti apo eventualisht vitin e ardhshëm, konsideroj se propozimi i këtij vendimi duhet të mbështetet nga të gjithë ne ngase nuk mund të lejojmë që në ndonjë kategori buxhetore të ketë mjete e në anën tjetër mësimdhënësit të mbeten pa paga mujore, kur jemi në dijeni se pjesa dërmuese e tyre varen prej pagës mujore.

z. Haki Rudari, theksoi, në rasti konkret vërejtja ime është vetëm për atë përse po vjen deri te mungesa e mjeteve dhe përse nuk bëhem planifikimet e duhura me kohë.

z. Isuf Latifi, theksoi, mungesa e mjeteve paraqitet për shkak se po e zëmë një punëtorë shkon në pushim të lehonisë, ajo e merr 70% të pagës mujore, mirëpo mësimdhënësi i cili e zëvendëson e merr pagën e plotë dhe kjo thuajse e dyfishon pagën mujore për një vend pune e rastet e këtilla vështir se nuk mund të planifikohen paraprakisht.

Pas votimit u konstatua se propozimi i këtij vendimi, Kuvendit njëzëri i rekomandohet për shqyrtim.

4. Rishqyrtimi i vendimit për miratimin e kërkesës z. Sabit Halitit nga Podujeva për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, për shkak të parcelizimit të ngastrës kadastrale nr. 607-2.

z. Durim Salihu, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, e paraqiti fjalën hyrëse.

z. Isuf Latifi, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, e paraqiti fjalën hyrëse.

Pas votimit u konstatua se propozimi i këtij vendimi, Kuvendit njëzëri i rekomandohet për shqyrtim.

Mbledhja përfundoi në orën 14.50 '

**Procesverbalin e mbajti
Faik Gashi**

**Nr. 01- 006-27717
Podujevë,
26 shkurt 2015**

**Kryesuesi i Komitetit
Mehmet Gashi**